



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME VLORE SH.A

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më __ / __ / 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirëmbajtje e sistem faturimi, arkëtimi dhe fiskalizim fature”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

72224100-2 SHËRBIMET E PROGRAMIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E SISTEMEVE

FONDI LIMIT

10,000,000 (dhjete milion) Leke pa TVSH Lekë pa tvsh.

Argumentimi: Përlllogaritja e vlerës së fondit limit është bërë referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetlës Kanalizime Vlore sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas Formularit përmbledhës të vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiar **2021, 2022 dhe 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43, pika 2, gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për MRRPP, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022 dhe 2023** të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 % të vlerës së së fondit të limit të përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik **për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shenohen vlera, afati i perfundimit të kontratës ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetem fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- ISO 9001 (për Standartin e Menaxhimit të Cilësisë)
- ISO 27001 (për Standartin e Sigurisë së Informacionit)

Të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë. Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standartet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Nisur nga proceset e punës kritike, rendesise se shërbimeve që sistemi ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, të bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara që garantojnë iso për sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe iso për sigurinë e informacionit.

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitet njerezore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 5 (pesë) punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatikë ekonomike, shkenca kompjuterike, etj.) si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e ofruar ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja
- b) Të paktën 1 (një) zhvillues software të certifikuar në nivel eksperti në zgjidhjen e faturimit ekzistues ose teknologjite nga të cilat përbëhet zgjidhja.
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesionist në implementimin e WEB shërbimeve nepermjet protokollit SOAP ose REST ose ekuivalent.
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e bazës së të dhënave të përdorura në zgjidhjen e ofruar
- e) Të paktën 1 (një) punonjës menaxher projekti të certifikuar në nivel profesional.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, për secilin prej punonjësve të sipër kërkuar:

1. Diplomat,
2. Certifikimet perkatese dhe
3. Formularët E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e Formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas Shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Që të sigurohet aftësia për implementimin e kërkesave për ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteteve, etj, kërkohet që OE duhet të ketë në stafin e propozuar me njohuri/aftësi të nevojshme të certifikuar nga prodhuesi i teknologjive baze të sistemit

Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilën nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdori personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mesiperme të ekspertizës si dhe numri i personelit të certifikuar, janë kryer në baze të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialistëve. Diplomimi i punonjesve në degët **informatike ose teknologji-informacioni ose elektronike, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës pasi ky objekt prokurimi përfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrimin, trajnimin e përdoruesve dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit.**

- a) Punonjësi i kërkuar në pikën ”a” vjen si nevojë për garantimin e aftësisë profesionale për implementimin e zgjidhjes për fiskalizim, zgjidhjen e incidenteve, problemeve dhe garantimin e implementimit e të gjithë specifikimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Ky specialist garanton funksionimin e të gjithë funksionaliteteve të programit përpara i takon implementimit
- b) Punonjësi i kërkuar në pikën ”b” vjen si nevojë për kryerjen e integritit dhe mirembajtjes, ku do të nevojitet kryerja e zhvillimeve dhe konfigurimeve në sistemin Flare Billing i cili është sistemi i faturimit që disponon Autoriteti Kontraktor. Ky specialist garanton funksionimin e të gjithë funksionaliteteve të programit përpara i takon integritit dhe komunikimit të sistemeve
- c) Punonjësi i kërkuar në pikën ”c” garanton integritimin nëpërmjet protokolleve të siperpërmendura ashtu siç është cituar në specifikimet teknike në paragrafin integriti dhe komunikimi
- d) Punonjësi i kërkuar në pikën ”d” garanton mirembajtjen, optimizimin, shmangien e ndërhyrjes ose manipulimit të databazës
- e) Punonjësi i kërkuar në pikën ”e” garanton ndjekjen e të gjithë ciklit të implementimit të projektit, që prej analizës dizajnimit të kërkesave, parametrizimeve, testimit dhe dokumentimit të projektit ashtu siç është cituar në specifikimet teknike në paragrafin Menaxhimi i projektit

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.

Argumentim: Bazuar ne Ligjin Nr 87/2019 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe të fiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e te mirëmbajtesve të zgjidhjeve software-ike duhet që operatorët të cilët ofrojnë këtë shërbim duhet të jenë të licensuar dhe te regjistruar në regjistrin e prodhuesve ose te mirëmbajtesve software-ike te AKSHI-it.

Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe termat e references jane hartuar nga inxhinieri IT, specialist i fushës, i cili ka njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Shënim: *Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose termat e references ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim është parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.*

*Shënim: Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Njesia e Prokurimit